36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **“Force Madhore”** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktoar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Emri i Autoritetit Kontraktues: Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi dhe Emri i Kontraktuesit: "AGE Group" Sh.p.k. me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Tahir Bala & N.P.T. "Bamirs" me adresë në Suharekë, të cilën e përfaqëson Gëzim Bajraktari janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë: TITULLI I KONTRATËS: RIPARIMI I MONUMENTEVE KULTURORE HISTORIKE Numri i Prokurimit: 623-18-7079-5-2-1 Numri i Brendshëm: 623-18-057-5-2-1
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	10% i ndalet një vit pas pranimit teknik të punimeve. Pagesa e shumës së ndalur në emër të sigurimit të punimeve (10%) mund të i paguhet: Operatorit Ekonomik me : - Vendim të Kryetarit të Komunës për leshimin e pageses së 10% të ndalur në emër të sigurimit të punimeve dhe - Nese OE e sjell garancionin nga ndonjë kompani e licencuar e sigurimeve ose nga ndonjë bankë (për periudhën për të cilën edhe është ndalur 10%). Pagesat kontraktuesit do t'i bëhet në bazë të raportit të organit mbikqyrës.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [5] ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Organi Mbykqyrës është: Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve të përgjithshme të kontratës.
Fillimi i punëve	10.1	Punët do të fillojnë brenda Pesë [5] dite pune pas ftesës nga autoriteti kontraktues përkatësisht nga ana e organit mbikëqyrës ose menaxheri i projektit. Ftesa për fillim të punëve do të behet me krijimin e kushteve atmosferike.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësive të lejuara nga organi mbikqyrës. Kontrata është: 24 muaj.

Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuese e defekteve është: 12 muaj.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: Sipas Kushteve të përgjithshme të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[shëno përqindjen]</i>
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës = 7,884.64 €, për kohëzgjatjen e periudhës prej: [24 muaj + 30 ditë].
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve. Pagesa do të behet vetëm për punët e përfunduara sipas raportit të organit mbikëqyrës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Autoriteti kontraktues cakton departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec] në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

RIPARIMI I MONUMENTEVE KULTURORE HISTORIKE

MULLIRI I HOXHAJVE

A	Punët Pregaditore				
Nr.	Specifikimi i Punimeve				
I	Përshkrimi i Pozicioneve	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
1	Pastrimi i terenit nga shkure si dhe mbeturinat tjera te cilat dalin në vend pusnishte para dhe gjatë ekzekutimit të punimeve . Vërejtje : mbeturinat e tubuara duhet të ngarkohen si dhe të deponohen në deponi të qytetit në largësi 5km.	m ²	400.00	1.00 €	400.00
2	Prerja e drunjëve, shkureve përgjat pronit , prerja bëhet me sharë motorike si dhe largimi i tyre nga vendpunishte.	m ²	260.00	1.00 €	260.00
3	Gërmimi , ngarkimi si dhe transporti i dheut i cili del nga proni gjatë gërmimit duhet ti ipet forma e pronit ne pjesën e poshtme b ₁ =130m' ndërsa në pjesën e sipërme b ₂ =350m' , dhe thellsia h=130cm' ku forma e prerjes tërthore të jet trapez.	m ³	405.60	1.00 €	405.60
4	Devijimi i shtratit te lumit gjate ekzekutimit te punimeve,largimin i sasise se ujit nje here nga ana e djathte,pastaj nga ana e majte ose anasjelltes dhe te punohet ne gjendje te terur pa prezencen e ujit.	m'	130.00	1.00 €	130.00
5	Perdorimi i pompave per largimin e ujerave gjate kryerjes se punimeve ndertimore (sipas nevojes).	paushall	1.00	0.10 €	0.10

6	Thyerja e betonit në pjesën e hyrjes me hilt , nivelizimi si dhe bartja në deponi e mbeturinave të tubuara pjesa e thyerjes është me gjërsi b=35cm' si dhe gjatësi l=150cm'.	m'	1.50	10.00 €	15.00
7	Demolimi i dritares ekzistuese me dimensione 30x60cm' në pjesën e konstruksionit të kulmit .	copë	1.00	10.00 €	10.00
8	Demolimi i dritares ekzistuese me dimensione 30x60cm' në pjesën e konstruksionit të kulmit .	copë	1.00	10.00 €	10.00
9	Demolimi i Derës ekzistuese me dimensione 150x205cm' në pjesën e hyrjes në objekt.	copë	1.00	10.00 €	10.00
10	Demolimi i Derës ekzistuese me dimensione 125x85cm' në pjesën e anësore të objektit .	copë	1.00	10.00 €	10.00
11	Demolimi i Derës ekzistuese me dimensione 205x70cm' në pjesën e zyrës së objektit .	copë	1.00	10.00 €	10.00
12	Demolimi i Dritareve ekzistuese me dimensione 100x75cm' në pjesën e anësore të objektit .	copë	2.00	10.00 €	20.00
13	Pastrimi i baltës në pjesën e mbrendëshme të objektit balta duhet të pastrohet me trashësi mesatare t=10cm' si dhe të bëhet ngarkimi ,transporti si dhe hudhja në deponi.	m ²	39.90	1.00 €	39.90
14	Demolimi i Konstruksionit të kulmit nga struktura e mbrendshme mërtek e kalbur si dhe mbulesa nga sallanit të valëzuara në qmim llogaritet që materiali i tubuar të ngarkohet si dhe të bartet në deponi të qytetit .	m ²	79.56	1.00 €	79.56
15	Demolimi i Konstruksionit të mbulesës në pjesën e zyrës së mbërndshme , mbulesa është nga mërtek e kalbur si dhe në pjesën e poshtme dhe të sipërme e gozhduar nga drasa t=2.0cm', materiali I demoluar duhet të ngarkohet si dhe të bartet në deponi të qytetit.	m ²	6.16	1.00 €	6.16

16	Largimi i objekteve në brendi të objekti të mullirit gjat ekzekutimin e punëve si dhe kthimi i tyre në vendet e caktuara pas ktyerjes së punimeve	copë	10.00	10.00 €	100.00
17	Thyerja , pastrimi , gërryerje e fugave , murit ekzistues në sipërfaqet e mbrendshme në thellsi deri në 3cm' në tërë sipërfaqen e mureve të mbrendshme për mbushjen e tyre me llaq të gatshëm me ngjyrë të bardhë.	m ²	63.00	0.50 €	31.50
18	Thyerjet, largimi i betoneve përreth mureve ekzistuese në pjesën e sipërme para se të bëhet betonimi i cerklazhit për të përforcuar kurorën e objektit.	m ²	137.50	1.00 €	137.50
19	Gërmimi i sipërfaqes para objekti si dhe ulja e trases në mënyrë që ti ipet ramje tërthore dhe gjatsore për largimin e ujërave atmosferikë	m ³	96.00	1.00 €	96.00
20	Thyerja , pastrimi , gërryerje e fugave , murit ekzistues në sipërfaqet e mbrendshme në thellsi deri në 3cm' në tërë sipërfaqen e mureve të jashtme për mbushjen e tyre me llaq të gatshëm me ngjyrë të bardhë.	m ²	63.00	1.00 €	63.00
21	Pastrimi i rezervarit nga mbeturina si dhe dherat të cilat dalin në brendi të tij materiali I tubuar duhet të ngarkohet , transportohet në deponi të qytetit.	m ³	135.00	1.00 €	135.00
22	Gërryerja e sipërfaqes së rrugës me trashësi t=15cm' si dhe gërsi b=4.5m' , gërryerja e dheut të kategoris së dytë dhe të tretë si dhe materiali I tubuar duhet të ngarkohet si dhe të bëhet transporti në deponi	m ²	720.00	1.00 €	720.00
				Totali:	2,689.32

CA

B		Punët Ndërtimore			
Nr.	Specifikimi i Punimeve	Njësia	Sasia	€ /Njësi	€ /Sasi
II	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
1	Furnizimi transporti si dhe Shtruarja e rrugës me zhavor , shtruarja të bëhet me trashësi t=25cm' me gjërsi të rrugës b=450cm' , të përzier me përbërje malore gjat shtruarjes të bëhet edhe rrafshimi për qarkullim të automjeteve bujqësore.	m ³	180	10.00 €	1,800.00
2	Furnizimi transporti si dhe rrafshimi i zhavorit para hyrjes ne objektin shtruarja të bëhet me trashësi t=20cm' .	m ²	156	3.00 €	468.00
3	Furnizimi, transporti si dhe vendosja në vepër e armaturës rrjetë me diametër fi 10 mm' 15x15cm' dimensionet e rrjetes janë 200x600cm'.	copë	1.00	38.00 €	38.00
4	Furnizimi transporti kallopimi si dhe betonimi i pllato para hyrjes në objekt , betonimi behet nga betoni MB 30 me trashësi t=15cm'.	m ²	12.00	10.00 €	120.00
5	Furnizimi transporti betonimi i cokllës me beton MB 25 para hyrjes në objekt me gjërsi b=35cm' , coklla gjindet nërr dyert e hyrjes , betonimi bëhet me trashësi t=20cm'.	m'	1.5	10.00 €	15.00
6	Furnizimi transporti si dhe punimi i pllato me rrasa të gurit me trashësi t=(3-5)cm' , para se të bëhet ngjitja e rasave bëhet lyerja me kontakt beton bazamenti . Rasat ngjiten me ngjitës si dhe bëhet mbushja e fugave të tyre .	m ²	14	12.00 €	168.00
7	Furnizimi , transporti , prerja , lakimi si dhe vuarja në vepër e armaturës së brinjëzuar S-400/500 në cmim llogaritet në kilogram.	kg	540	1.00 €	540.00
8	Furnizimi transporti , latimi , betonimi si dhe vibrimi i betonit MB 30 në bazamenti e mbrenshem si dhe , trajet e kurorës së mureve , si dhe pas forcimit të betonit duhet të bëhet cmontimi i drasave .	m ³	7.40	35.00 €	259.00

9	Furnizimi transporti si dhe montimi i dritares nga kornizat e drunit si dhe nga pjesa e mbrenshe me xhamat e tejdukshem , dimensionet e dritareja janë 30x60cm'. Në cmim llogariten të gjitha punët si lyerja vendosja e rezeve tj.	copë	1.00	35.00 €	35.00
10	Furnizimi transporti si dhe montimi i dritares nga kornizat e drunit si dhe nga pjesa e mbrenshe me xhamat e tejdukshem , dimensionet e dritareja janë 30x40cm'.	copë	1.00	35.00 €	35.00
11	Furnizimi transporti si dhe montimi i dyerve të hyrjes nga materiali Druri i përpunuar, dimensionet e dyerve janë 150x205cm' , dyert duhen të jen dy krahëshe si dhe në pjesen e sipërme duhet të jen me hapje për ndriqimin e hapsirës .Vërejtje: dyert duhet të vendosen si dhe të jen me pjesët përcjellëse po ashtu dyert duhet të jen të ngjyrosura në dy shtresa me nuanc të përcaktuar nga organi mbikqyrës.	copë	1.00	500.00 €	500.00
12	Furnizimi transporti si dhe montimi i dyerve anësore nga materiali Druri i përpunuar, dimensionet e dyerve janë 120x85cm' , dyert duhen të jen nje krahëshe si dhe në pjesen e sipërme duhet të jen me hapje për ndriqimin e hapsirës .Vërejtje: dyert duhet të vendosen si dhe të jen me pjesët përcjellëse po ashtu dyert duhet të jen të ngjyrosura në dy shtresa me nuanc të përcaktuar nga organi mbikqyrës.	copë	1.00	110.00 €	110.00
13	Thyerja me hilt si dhe rafshimi i sipërfaqeve ne pjesen e siperme të të murit i cili është nga betoni , thyerja duhet të bëhet pasi që sipërfaqet nuk janë të rrafshta, në cmim llogaritet për metër gjatsi gjërsia e rafshimit është b=35cm'.	m'	19.00	10.00 €	190.00



14	Furnizimi transporti si dhe ngjitja e pllakave të gurit me trashësi $t=(3-5)\text{cm}'$ në pjesën e sipërme të raftevenë muret .Pllaka duhet të ngjiten me ngjitës special si dhe mbushja e fugave të tyre si dhe pastrimi i tyre.	m^2	2.80	12.00 €	33.60
15	Furnizimi transporti si dhe punimi i bazamentit në brendi të objekti me pllaka të gurit , pllaka janë ne trashësi $t=7\text{cm}'$, montimi i tyre bëhet me ngjitës specialë lyerja bëhet në pjesën e poshtme si dhe duhet të bëhet edhe mbushja e fugave me ngjitës , fugat janë me trashësi $t=(2-3)\text{cm}'$.	m^2	41.50	14.00 €	581.00
16	Furnizimi transporti , muratimi i murit të dëmtuar me gurë të përpunuar, gurët të ken formën sipas mureve ekzistuese , muratimi bëhet me llaq qimentoje në cmim llogaritet për m^3 . gjërsi e murit duhte të punohet $b=65\text{cm}'$ ku në mes të murit duhet të bëhet edhe përforsimi i tij me rrjet të armatures si dhe me beton të markës MB 30 .	m^3	7.50	50.00 €	375.00
17	Furnizimi, transporti si dhe mbushja e fugave ne pjesen e mbrenshme si dhe të jashme te objekti me llaq me ngjyrë të bardhë , mbushja e fugave bëhet në tërrë sipërfaqet e mbrenshme të mureve prej gurëve natyralë	m^2	143.00	3.00 €	429.00
18	Furnizimi transporti si dhe punimi i kapakut prej metali , ne këtë pozicion perfshihen si punimi i kornizes vendosja e rezeve si dhe pjesa e mbulojes me pllak metalike me trashesi $t=3\text{mm}'$ duke përfshirë edhe ngjyrosjen e saj. Dimenzionet e pllakës janë $(60 \times 60)\text{cm}'$	copë	1.00	50.00 €	50.00

19	Riparimi i mureve me gurë natyralë në sipërfaqet e mbrendshme si dhe ato të jashtme , gurët duhet të ken form të përpunuar , ngjitja e gurëve bëhet me llaq qimentoje. Ku trashësia e mureve ekzistuse është b=65cm'.	m ²	68.00	1.00 €	68.00
20	Furnizimi transporti si dhe lyerja me material të gatshëm e mureve në pjesët e mbrendshme si dhe të jashtme ku është pjesa e betonit si dhe bllokat e betoni , para se të bëhet lyerja duhet të bëhet lyerja me kontakt beton , dy shtresa me material të gatshëm si dhe fini si pjes finale .	m ²	68.00	6.00 €	408.00
21	Furnizimi transporti si dhe ngjitja e pllakave të gurit në muret e zyrës së mbrendshme , pllakat duhet te jenë me trashësi t=2-3cm' të cilat ngjiten në muret me llaq special si dhe duhet të bëhet mbushja e fugave të tyre me ngjitës ngjyë të bardhë.	m ²	8.00	12.00 €	96.00
22	Furnizimi transporti si dhe ngjitja e pllakave të gurit në muret e oxhakut në zyre , pllakat duhet te jenë me trashësi t=2-3cm' të cilat ngjiten në muret me llaq special si dhe duhet të bëhet mbushja e fugave të tyre me ngjitës ngjyë të bardhë.	m ²	3.20	10.00 €	32.00
23	Furnizimi , transporti si dhe montimi i dritareve nga druri i përpunuar dritaret duhet të jen statike me një korniz si dhe pjesa e mbrendshme me xham të tejdukshëm me trashësi t=4mm'. Dimensionet e dritareve janë 75x100cm'	copë	2.00	100.00 €	200.00
24	Furnizimi transporti si dhe montimi i dyerve të drurit të përpunuar ,dyert duhet të jen krahu I djathë ku gjërsia e tokut duhet të matet në vend ngjarje para se të bëhet porosia , dyert duhet të jen me të gjitha pjesët përcjellëse për funksionimin e tyre si reze qels etj. dimensionet e dyerve janë 75x205cm'	copë	1.00	120.00 €	120.00

25	Furnizimi transporti si dhe montimi i mērtēkve në pjesën e konstruksionit të kulmit të zyres së mbrendshme , mērtēk janë me prerje tērtthore 10x12cm, ku sipër bëhet izolimi i tyre me drasa t=1.8cm',të gjithë elementet e drurit duhet të ngjyrosen me sadolin , në pjesen e sipërme pinohen letva si dhe mbulimi në form të kulmeve me rasa deri në trashësi t=3cm' duke e emituar kulmet e vjetra me mbuloj të rasave.	m ²	4.50	12.00 €	54.00
26	Furnizimi ,transporti si dhe montimi i kurorës së konstruksionit të kulmit me mērtēk me prerje terthore 10x12cm' mērtēk duhet tb ankerohen me bulona M12mm' cdo një meter.	m'	23.00	3.00 €	69.00
27	Furnizimi transporti si dhe montimi i mērtēkve në pjesën e konstruksionit të kulmit në pjesën e mbajtësve , mērtēk vendosen në ramjen e konstruksionit të kulmit ku prerja tērtthore e tyre është 10x12cm' në këtë pozicionë llogaritet të lihet pjesa e strehës l=60cm', të gjitha mērtēk duhet të lyhen me sadolinë si dhe duke llogaritur të gjitha punët paraprake si pērpunimi gozhdimi etj.	m ²	80.00	20.00 €	1,600.00
28	Furnizimi transporti si dhe punimi i kallkaneve nga guri i pērpunuar gjērsia e murit në kallkane është b=65cm' ku lartēsi e mbylljes së kallkaneve është 25cm', gurēt duhet të ngjiten me llaq speciale me ngjyë të barlle ku I cili duhet të jet rezistent ndaj kushteve atmosferike ngrirje- shkrirje kule i pērballuar 15 cikle .	m'	33.00	7.00 €	231.00

29	Furnizimi transporti si dhe drasimi i konstruksionit të kulmit me drasa me trashësi $t=1.8\text{cm}$, drasimi bëhet si nga brenda ashtu edhe jashtë objekti duke përfshir edhe strehën , në këtë pozicionë llogaritet edhe ngjyrosja në pjesën e mbrendshme në dy shtresa si dhe gozhdimi i tyre me të gjitha punët paraprake.	m ²	100.00	5.00 €	500.00
30	Furnizimi transporti si dhe vendosja e folis izoluse në pjesën e konstruksionit të kulmit sipër drasave .	m ²	130.00	1.00 €	130.00
31	Furnizimi transporti dhe mbjellja e druve dekorativ me të gjitha punët paraprake si germimi i gropave mbjellja dhe mbushja e gropave me dheun adekuar, në pjesën e trotuarit operatori duhet ta punojë kuroren rreth drurit të mbjellur me anesore si dhe në pjesë e mbrendshme të mbjell me bari si dhe është i obliguar që të kujdeset deri në afatin e komisionit për pranimin teknik.	cope	5.00	25.00 €	125.00
32	Furnizimi transporti dhe vendosja e karikave me dimensione 60x80x160cm' karika duhet të jenë nga konstruksioni i profileve metaleke , të cilat janë të ngjyrosuar me dy shtresat e ngjyresë yndyrshëm si dhe në pjesën e uljes dhe në pjesën e shpines duhet të punohen nga drunjt sipas standardeve duhe filluar nga pjesa e ulës deri në pjesën e sipërme të shpines duke mos e ndërpsë sipas konstruksionit të trupit të njeriut me dru bungu me përqindje minimale e lageshtis si dhe të jetë i ngjyrosur në dy shtresa të llakit . .	cope	2.00	50.00 €	100.00



33	Furnizimi transporti si dhe muratimi i oxhakut me tulla nise , muratimi bëhet në lartësi h=1.3m' , muratimi bëhet me llaq qimentoje si dhe në pjesën e sipërme vendosen oxhaku prej betoni për largimin e ujrave si dhe mbyllja e tij me rrjeta për mos depërtimin e shpendëve .	copë	1.00	50.00 €	50.00
34	Furnizimi ,transporti si dhe lyerja e pjesës së mureve me ngjyrë të bardhë , lyerja bëhet në dy shtresa.	m ²	68.00	1.30 €	88.40
35	Furnizimi ,transporti si dhe montimi i ollugeve horizontale si dhe atyre vertikale , lugjeve si dhe skajoreve duke i përfshirë të gjitha lidhjet kurorat kthesa etj. në cmim llogariten për meter gjatësi.	m'	48.00	8.00 €	384.00
36	Furnizimi transporti si dhe vendosje e pllakës për emrimin Mullirti me mbishkrime sipas kërkesës së investitorit dimensionet e pllakës janë 40x80cm' , në qmim llogariten të gjitha punët paraprake.	copë	1.00	50.00 €	50.00
37	Furnizimi , transporti , si dhe muratimi i murit me blloka të betonit me dimensione 20x20x40 cm' , Në cmim llogaritet në m ² duke përfshirë tërë gjatësin - Lartësin e murit .	m ²	1.20	20.00 €	24.00
Totali:					10,076.00



A	Punët Pregaditore	2,689.32
B	Punët Ndërtimore	10,076.00
	TOTALI :	12,765.32

KRONI NE SHESHIN E REPUBLIKES I					
A	Punët Pregaditore				
Nr.	Specifikimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
I	Përshkrimi i Pozicioneve				
1	Pastrimi i terenit nga mbeturinat tjera te cilat dalin në vend pusnishte para dhe gjatë ekzekutimit të punimeve . Vërejtje : mbeturinat e tubuara duhet të ngarkohen si dhe të deponohen në deponi të qytetit në largësi 5km.	m ²	50.00	0.10 €	5.00
2	Thyerja e betonit në pjesën e pllato me hilt , nivelizimi si dhe bartja në deponi e mbeturinave të tubuara pjesa e thyerjes është me gjësi b=100cm' si dhe gjatësi l=320cm'.	m ²	3.20	1.00 €	3.20
3	Demolimi i Konstruksionit të mbulesës në pjesën e sipërme të përroit , mbulesa është nga gurët e përpunuar materiali i demoluar duhet të ngarkohet si dhe të bartet në deponi të qytetit.	m ²	0.90	1.00 €	0.90
4	Thyerja , pastrimi , gërryerje e fugave të murit ekzistues në sipërfaqet e mbrendshme në thellsi deri në 3cm' në tërë sipërfaqen e mureve për mbushjen e tyre me llaq të gatshëm me ngjyrë të bardhë.	m ²	8.00	1.00 €	8.00
5	Gërmimi i sipërfaqes para objekti si dhe ulja e trases në mënyrë që ti ipet ramje tërthore dhe gjatsore për largimin e ujërave atmosferikë	m ³	3.50	1.00 €	3.50
6	Thyerja përreth si dhe Demolimi i ujëmbledhësit ekzistues si dhe kurorës nga metali	copë	1.00	1.00 €	1.00

7	Pastrimi i koritës si dhe gypit të derdhjes së ujit nga mbeturina si dhe dherat të cilat dalin në brendi të tij materiali i tubuar duhet të ngarkohet , transportohet në deponi të qytetit.	m ³	1.00	5.00 €	5.00
				Totali:	26.60

B Punët Ndërtimore					
Nr.	Specifikimi i Punimeve	Njësia	Sasia	€ /Njësi	€ /Sasi
II	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
1	Furnizimi transporti si dhe rafshimi i zhavorit para përoit ,shtruarja të bëhet me trashësi t=15cm' .	m ²	0.8	15.00 €	12.00
2	Largimi i Kubzave ekzistuese përgjat skait të rrugës për gjurmimin e kanalit si dhe vendosjen e gypit të ri për prurjen e ujit në projin e sheshit të republikës. Pas përfundimit të punimeve kubzat duhet të kthehen në gjendjen e më parshme .	m ²	112	3.50 €	392.00
3	Gërmimi i kanalit për vendosjen e gypit të ri të ujit , Gërmimi I dheut të kategoris së Vderi VII , gjërsia e kanalit është b=50cm' si dhe thellsia h=75cm', pas përfundimit të punimeve pjesa e materialit duhet të kthehet në gjendjen e më parshme si dhe pjesa e materialit të tëpërt duhet të ngarkohet si dhe të bartet në deponi të qytetit.	m ³	52.5	2.00 €	105.00
4	Furnizimi transporti si dhe shtrirja e rrërës së imët nër gyp si dhe mbi tij	m ³	10.5	10.00 €	105.00
5	Furnizimi transporti si dhe shtrirja e gypit me diametër fi 63mm' për prurjen e ujit në përojin e Sheshit të Republikës	m'	145	2.00 €	290.00

6	Furnizimi transporti si dhe lidhjet (kyqjet) e gypit në rrjetin ekzistues si dhe në pjesën e përroit në këtë pozicionë llogariten të gjitha punët paraprake si vendosja e ventilave, lidhseve etj.	copë	2	20.00 €	40.00
7	Furnizimi transporti si dhe punimi i kubzave në pjesën e dëmtuar të rrugës e cila është e gërmuar .	m ²	15	10.00 €	150.00
8	Furnizimi, transporti si dhe vendosja në vepër e armaturës rrjetë me diametër fi 8 mm' 15x15cm' dimensionet e rrjetes janë 100x300cm'.	copë	1.00	30.00 €	30.00
9	Furnizimi transporti kallopimi si dhe betonimi i pllatos si dhe punimi i koritës për mbelljen e ujit para , betonimi behet nga betoni MB 30 me trashësi t=15cm'.	m ³	0.87	40.00 €	34.80
10	Furnizimi transporti si dhe punimi i pllatos me rrasa të gurit me trashësi t=(5-7)cm' , para se të bëhet ngjitja e rasave bëhet lyerja me kontakt beton bazamenti . Rasat ngjiten me ngjitës si dhe bëhet mbushja e fugave të tyre .	m ²	6.4	14.00 €	89.60
11	Furnizimi , transporti , prerja , lakimi si dhe vuarja në vepër e armaturës së brinjëzuar S-400/500 në cmim llogaritet në kilogram.	kg	35	1.00 €	35.00
12	Thyerja me hilt si dhe rrafshimi i sipërfaqeve ne pjesen e siperme të të murit i cili është nga betoni , thyerja duhet të bëhet pasi që sipërfaqet nuk janë të rrafshta, në cmim llogaritet për metër gjatësi gjërsia e rrafshimit është b=35cm'.	m'	3.20	1.00 €	3.20
13	Furnizimi transporti , muratimi i murit të dëmtuar me gurë të përpunuar, gurët të ken formën sipas mureve ekzistuese , muratimi bëhet me llaq qimentoje në cmim llogaritet për m ³ .	m ³	1.45	70.00 €	101.50

14	Furnizimi, transporti si dhe mbushja e fugave ne pjesen e mbrenshme si dhe të jashme te përroit me llaq me ngjyrë të bardhë , mbushja e fugave bëhet në tërë sipërfaqet e mbrenshme të mureve prej gurëve natyralë	m ²	10.44	5.00 €	52.20
15	Furnizimi transporti si dhe punimi i ujëmbellësit prej metali , ne këtë pozicion perfshihen si punimi i kornizes vendosja e rezeve si dhe pjesa e mbulojes me pllak metalike në form të rrjetës me trashesi t=3mm' duke përfshirë edhe ngjyrosjen e saj. Dimenzionet e pllakës janë (30x60)cm'	copë	1.00	30.00 €	30.00
16	Furnizimi ,transporti si dhe montimi i kurorës së konstruksionit të kulmit me mërtek me prerje terthore 10x12cm' mërtek duhet th ankerohen me bulona M12mm' cdo një meter.	m'	2.40	20.00 €	48.00
17	Furnizimi transporti si dhe montimi i mërtekve në pjesën e konstruksionit të kulmit në pjesën e mbajtësve , mërtek vendosen në ramjen e konstruksionit të kulmit ku prerja tërthore e tyre është 10x12cm' në këtë pozicionë llogaritet të lihet pjesa e strehës l=50cm', të gjitha mërtek duhet të lyhen me sadolinë si dhe duke llogaritur të gjitha punët paraprake si përpunimi gozhdimi etj.	m ²	3.84	30.00 €	115.20
18	Furnizimi transporti si dhe drasimi I konstruksionit të kulmit me drasa me trashësi t=1.8cm' , drasimi bëhet si nga brenda ashtu edhe jash objekti duke përfshir edhe strehën , në këtë pozicionë llogaritet edhe ngjyrosja ne pjesen e mbrenshme si dhe gjozhdimi i tyre me të gjitha punët paraprake.	m ²	3.84	6.00 €	23.04
19	Furnizimi transporti si dhe vendosja e folis izoluse në pjesën e konstruksionit të kulmit sipër drasave .	m ²	3.84	1.00 €	3.84

20	Furnizimi transporti si dhe mbukimi i konstruksionit të kulmit me rrasa të gurit me trashësi $t=2-3\text{cm}$ rrasa duhet të mbulojn pesn e mbulesës duke emituar konstruksionet e mbulesës me pamje arkeologjike.	m^2	3.84	15.00 €	57.60
21	Furnizimi transporti dhe mbjellja e druve dekorativ me te gjitha punet paraprake si germimi i gropave mbjellja dhe mbusha e gropave me dheun adekuar, ne pjesen e trotuarit operatori duhet ta punoje kuroren rreth drunit te mbjellur me anesore si dhe ne pjese e mbrendeshme te mbjell me bari si dhe eshte i obliguar qe te kujdeset deri ne afatin e komisionit per pranimin teknik.	cope	8.00	25.00 €	200.00
22	Furnizimi transporti dhe vendosja e karikave me dimensione $60 \times 80 \times 160\text{cm}$ karika duhet te jene nga konstruksioni i profileve metaleke , te cilat jane te ngjyrosuar me dy shtresat e ngjyres se yndyreshem si dhe ne pjesen e uljes dhe ne pjesen e shpines duhet te punohen nga drunjet sipas standardeve duhe filluar nga pjesa e uleses deri ne pjesen e siperme te shpines duke mos e nderpsre sipas konstruksionit te trupit te njeriut me dru bingu me perqindje minmale e lageshtis si dhe te jet i ngjyrosur ne dy shtresa te llakit . .	cope	4.00	50.00 €	200.00
23	Furnizimi ,transporti si dhe montimi I olluqeve horizontale si dhe atyre vertikale , lugeve si dhe skajoreve duke I perfshire te gjitha lidhjet kurorat kthesa etj, në cmim llogariten për meter gjatsi.	m'	13.60	10.00 €	136.00
24	Furnizimi transporti si dhe vendosje e pllakës për emrimin e krinit me mbishkrime sipas kërkesës së investitorit dimensionet e pllakës janë $40 \times 80\text{cm}$, në qmim llogariten të gjitha punët paraprake.	copë	1.00	20.00 €	20.00

25	Furnizimi ,transporti si dhe montimi qeshmeve për krojet në pjesën e burimit qeshme duhet të jen maga materiali inox dhe diameti i tyre duhet të jet 3/4	copë	2.00	10.00 €	20.00
				Totali:	2,293.98

A	Punët Pregaditore	26.60
B	Punët Ndërtimore	2,293.98
TOTALI :		2,320.58

KRONI NE LAGJEN E EPERME					
A	Punët Pregaditore				
Nr.	Specifikimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
I	Përshkrimi i Pozicioneve				
1	Pastrimi i terenit nga mbeturinat tjera te cilat dalin në vend pusnishte para dhe gjatë ekzekutimit të punimeve . Vërejtje : mbeturinat e tubuara duhet të ngarkohen si dhe të deponohen në deponi të qytetit në largësi 5km.	m ²	60.00	1.00 €	60.00
2	Thyerja e betonit në pjesën e pllatos me hilt , nivelizimi si dhe bartja në deponi e mbeturinave të tubuara pjesa e thyerjes është me gjërsi b=100cm' si dhe gjatsi l=320cm'.	m ²	8.00	1.00 €	8.00
3	Thyerja e koritës ekzistuse nga betoni i armuar si dhe ngarkimi i materialit të tubuar bartja në deponi të qytetit	m ³	0.80	1.00 €	0.80
4	Gërmimi i sipërfaqes para objekti si dhe ulja e trases në mënyrë që ti ipet ramje tërthore dhe gjatsore për largimin e ujërave atmosferikë	m ³	65.20	1.00 €	65.20
5	Gërmimi i kanalit për vendosjen e gypit të derdhjes së ujit të tepërt nga korita e qeshme deri te korita gjatsore. Preja terthore e kanalit është 50x50cm'	m'	3.50	3.00 €	10.50
				Totali:	144.50

Punët Ndërtimore					
B					
Nr.	Specifikimi i Punimeve	Njësia	Sasia	€ /Njësi	€ /Sasi
II	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
1	Furnizimi transporti si dhe rafshimi i zhavorit para përroit ,shtruarja të bëhet me trashësi t=15cm' .	m ²	9.78	5.00 €	48.90
2	Furnizimi, transporti si dhe vendosja në vepër e armaturës rrjetë me diametër fi 8 mm' 15x15cm' dimensionet e rrjetës janë 100x300cm'.	copë	1.00	1.00 €	1.00
3	Furnizimi transporti kallopimi si dhe betonimi i pllatos si dhe punimi i koritës për mbelljen e ujit para , betonimi behet nga betoni MB 30 me trashësi t=15cm'.	m ³	0.87	30.00 €	26.10
4	Furnizimi transporti si dhe punimi i pllatos me rrasa të gurit me trashësi t=(3-5)cm' , para se të bëhet ngjitja e rasave bëhet lyerja me kontakt beton bazamenti . Rasat ngjiten me ngjitës si dhe bëhet mbushja e fugave të tyre .	m ²	6.4	15.00 €	96.00
5	Furnizimi , transporti , prerja , lakimi si dhe vuarja në vepër e armaturës së brinjëzuar S-400/500 në cmim llogaritet në kilogram.	kg	35	1.00 €	35.00
6	Furnizimi transporti si dhe montimi i kubëzave në pjesën e përparme të përroit kubza janë nga marka e betonit MB30 si dhe me trashësi t=8cm' .pasi të vendosen kubëza duhet të bëhet shtruarja e rrërës për mbushjen e fugave të tyre.	m ²	65.20	9.00 €	586.80



7	Furnizimi transporti , si dhe meremetimi i kubëzave të dëmtuara në pjesën e rrugës në cmim llogaritet si largimi I tyre mbusha me zhavor si dhe kthimi I tyre ne gjendjen e nivelizuar si dhe pjesa e dëmtuar duhet të zëvendësohet me të reja.	m ²	6.00	4.00 €	24.00
8	Furnizimi, transporti si dhe mbushja e fugave ne pjesen e mbrenshme si dhe të jashme te përroit me llaq me ngjyrë të bardhë , mbushja e fugave bëhet në tërë sipërfaqet e mbrenshme të mureve prej gurëve natyralë	m ²	10.44	2.00 €	20.88
9	Furnizimi transporti si dhe punimi i ujëmblesit prej metali , ne këtë pozicion perfshihen si punimi i kornizes vendosja e rezeve si dhe pjesa e mbulojes me pllak metalike në form të rrjetës me trashesi t=3mm' duke përfshirë edhe ngjyrosjen e saj. Dimenzionet e pllakës janë (30x20)cm'	copë	1.00	10.00 €	10.00
10	Gërmimi i kanalit për kyqjen e ujit nga gypi kryesor deri te përroi në gmm llogaritet si gërmimi I kanalit me gjersi b=50cm' si dhe thellsi h=70cm' kthimi i dheut të gërmuar ne gjendjen e më parshem vendosja e gypit 3/4 lidhjet e gypit si dhe të gjitha punët paraprake	m'	7.50	1.00 €	7.50
11	Furnizimi transporti si dhe punimi I ujëmblesit në brendi të koritës së përroit , në pozicionë llogariten të gjitha punët paraprake si lidhejt etj.	copë	1.00	10.00 €	10.00



12	Furnizimi transporti dhe mbjellja e druve dekorativ me te gjitha punet paraprake si germimi i gropave mbjellja dhe mbusha e gropave me dheun adekuar, ne pjesen e trotuarit operatori duhet ta punoje kuroren rreth drunit te mbjellur me anesore si dhe ne pjese e mbrendeshme te mbjell me bari si dhe eshte i obliguar qe te kujdeset deri ne afatin e komisionit per pranimin teknik.	cope	4.00	25.00 €	100.00
13	Furnizimi transporti dhe vendosja e karikave me dimensione 60x80x160cm' karika duhet te jene nga konstruksioni i profileve metaleke , te cilat jane te ngjyrosuar me dy shtresat e ngjyers se yndyreshem si dhe ne pjesen e uljes dhe ne pjesen e shpines duhet te punohen nga drunjet sipas standardeve duhe filluar nga pjesa e uleses deri ne pjesen e siperme te shpines duke mos e nderpsre sipas konstruksionit te trupit te njeriut me dru bingu me perqindje minmale e lageshtis si dhe te jet i ngjyrosur ne dy shtresa te llakit . .	cope	2.00	50.00 €	100.00
14	Furnizimi transporti si dhe punimi i gypit PVC për derdhej e ujit nga korita gjatsore deri në pjesën e poshtme të prockës dullo, diameti i gypit është fi 110mm' , në cmim llogaritet për m' me të gjitha pjesët përcjellëse.	m'	2.00	3.00 €	6.00
15	Furnizimi transporti si dhe betonimi i koritës me muret t=15cm' me thellsi h=60cm' dhe gjatsi të koritës l=600cm'	m'	6.00	1.00 €	6.00

16	Furnizimi transporti si dhe mveshja e koritës me rasa të gurit me trashësi t=2-3cm' si dhe para se të mveshen duhet të lyhet me kontakt beton , rasat duhet të ngjithen me ngjitës special për ngjitjen e pllakave si dhe duhet të bëhet edhe mbushja e fugave me ngjitës të bardhe , duke përfshir të gjitha punët paraprake.	m ²	10.60	15.00 €	159.00
17	Furnizimi transporti si dhe vendosje e pllakës për emrimin e krinit me mbishkrime sipas kërkesës së investitorit dimensionet e pllakës janë 40x80cm', në qmim llogariten të gjitha punët paraprake.	copë	1.00	15.00 €	15.00
18	Furnizimi ,transporti si dhe montimi qeshmeve në pjesën e burimit qeshme duhet të jen maga materiali inox pasi që mos diametri i tyre duhet të jet 3/4	copë	1.00	5.00 €	5.00
Totali:					1,257.18

A	Punët Pregaditore	144.50
B	Punët Ndërtimore	1,257.18
TOTALI :		1,401.68

KRONI TE SAHAT KULLA					
A	Punët Pregaditore				
Nr.	Specifikimi i Punimeve				
I	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
1	Pastrimi i terenit nga mbeturinat tjera te cilat dalin në vend pusnishte para dhe gjatë ekzekutimit të punimeve . Vërejtje : mbeturinat e tubuara duhet të ngarkohen si dhe të deponohen në deponi të qytetit në largësi 5km.	m ²	45.00	1.00 €	45.00

Handwritten signature

2	Thyerja e betonit në pjesën e pllatos me hilt , nivelizimi si dhe bartja në deponi e mbeturinave të tubuara pjesa e thyerjes është me gjësi b=100cm' si dhe gjatësi l=120cm'.	m ²	1.20	20.00 €	24.00
3	Thyerja , pastrimi , gërryerje e suvatimit të murit ekzistues në sipërfaqet e mbrendshme në thellsi deri në 2cm' në tërë sipërfaqen e mureve për mbushjen e tyre me llaq të gatshëm me ngjyrë të bardhë.	m ²	3.20	1.00 €	3.20
4	Gërmimi i sipërfaqes para objekti si dhe ulja e trases në mënyrë që ti ipet ramje tërthore dhe gjatsore për largimin e ujërave atmosferikë	m ³	3.50	5.00 €	17.50
5	Thyerja përreth si dhe Demolimi i ujëmbellësit ekzistues si dhe kurorës nga metali	copë	1.00	5.00 €	5.00
6	Pastrimi i koritës si dhe gypit të derdhjes së ujit nga mbeturina si dhe dherat të cilat dalin në brendi të tij materiali i tubuar duhet të ngarkohet , transportohet në deponi te qytetit.	m ³	1.00	5.00 €	5.00
				Totali:	99.70

Punët Ndërtimore					
B					
Nr.	Specifikimi i Punimeve	Njësia	Sasia	€ /Njësi	€ /Sasi
II	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Total
1	Furnizimi transporti si dhe rafshimi i zhavorit para përoit ,shtruarja të bëhet me trashësi t=15cm' .	m ²	2	5.00 €	10.00
2	Largimi i Kubzave ekzistuese përgjat skait të rrugës për gërmimin e kanalit si dhe vendosjen e gypit të ri për prurjen e ujit në projin e sheshit të republikës. Pas përfundimit të punimeve kubzat duhet të kthehen në gjendjen e më parshme .	m ²	78	3.50 €	273.00

3	Gërmimi i kanalit për vendosjen e gypit të ri të ujit , Gërmimi i dheut të kategoris së V deri VII , gjërsia e kanalit është b=50cm' si dhe thellsia h=75cm', pas përfundimit të punimeve pjesa e materialit duhet të kthehet në gjendjen e më parshme si dhe pjesa e materialit të tepërt duhet të ngarkohet si dhe të bartet në deponi të qytetit.	m ³	48.75	5.00 €	243.75
4	Furnizimi transporti si dhe shtrirja e rrërës së imët nër gyp si dhe mbi tij	m ³	9.75	10.00 €	97.50
